

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Furnizim vendosje pjesë këmbimi dhe mirëmbajtje e automjeteve të Bashkisë Kolonjë viti 2025 – 2026”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

50800000-3 - Shërbime të ndryshme për riparim dhe mirëmbajtje,

34330000-9 - Pjesë këmbimi për automjete, furgonë dhe makina transporti mallrash,

34900000-6 - Pajisje të ndryshme transporti dhe pjesë këmbimi,

VLERA E FONDIT LIMIT: 16,755,744.0 (Gjashtëmbëdhjetë milionë shtatëqind e pesëdhjetë mijë shtatëqind e dyzetë e katër) lekë pa tvsh ose 173,096.53 (njëqind e shtatëdhjetë e tremijë e nëntë dhjetë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre) Euro

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c i ndryshuar me ligjin nr.16 datë.08.02.2024 dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Kolonjë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” , i ndryshuar me ligjin nr.16 datë.08.02.2024 si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas percaktimeve të bëra në Shtojcën 8 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

(shënim: *plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë*).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 42 pika 3 dhe nenin 43 pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi I viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

Nenin 43 pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;”. Në rastin konkret nga ana e Njësisë së Prokurimit është konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/b, AK nuk mund të tejkalojë vlerën e përlllogaritur limit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se vlera e përlllogaritur për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore.

2.2.2 Operatori/et ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2022-2023-2024**, të çertifikuara nga autoritetet përkatëse, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e percaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë

19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Ligjit Nr. 10091 datë 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar).

Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës**, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrijnë ose e kalojnë shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrijnë ose e kalojnë shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.2.3. Operatori/et ekonomikë ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetin për vitin 2024 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore dhe për vitin e fundit 2025 (këstet e maturuara).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin nr.16 datë.08.02.2024 si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **në një vlerë jo më të vogël se 40 %** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet), të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në **nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”**, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ,i ndryshuar ,me ligjin nr.16 datë.08.02.2024, pika 4 ku parashikohet se: “*Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,ku parashikohet se:*Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin*

me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë **në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës**, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

si dhe rekomandimit Nr.17971 Prot.datë.10.03.2022 të agjensisë së prokurimit publik.Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanëpërvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë **në një vlerë jo më të vogël se 40 %** të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

Në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” , i ndryshuar me ligjin nr.16 datë.08.02.2024 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar .

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kërkuar objekt procedure prokurimi e cila ështëmidis kufirit të ulët dhe të lartë monetar është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë realizuar kontrata të ngjashme, të jetë afër limitit maksimal të lejuar pra **në një vlerë jo më të vogël se 40 %** të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit ,nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës dhe është në masën 40% të fondit limit.

2.3.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë personelin kryesor, si mëposhtë:

a. 1 (një) inxhinier mekanik

Për të cilin duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale të punës
- Diplomë ose certifikatë
- Të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë **minimalisht për muajin e fundit.**

ose

mund të jetë i kontraktuar me kontratë pune të rregullt për këtë procedurë prokurimi ku për të cilin të paraqiten:

- Kontratë individuale të punës
- Diplomë ose certifikatë

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të neni 4 pika 18 , pikës 4 të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar me ligjin nr. **16** datë. **08.02.2024**, dhe nenit 40, pika 5/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që kontraktuesi duhet të përcaktojë një person përgjegjës për kryerjen e shërbimeve i cili ka një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Kjo kontratë publike përfshin blerjen (hyrjen në magazine të mallit) me pas vendosjen dhe instalimin.

Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e veçanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit, sikundër janë, kontratë pune e vlefshme, diploma etj janë vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se ky person përgjegjës është operativ pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet. Stafi teknik i kualifikuar është kërkuar në raport me shërbimet që kërkohen të realizohen etj. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit.

2.3.3. Operatori/et ekonomik duhet të disponojë brenda territorit të Bashkisë Kolonjë minimumi **1 (një)** ambient pune (servis/oficinë) të përshtatshme për kryerjen e shërbimeve për të gjitha llojet e mjeteve sipas specifikimeve teknike objekt në funksion të realizimit të kontratës, të përshtatshëm për ushtrim aktiviteti sipas objektit të prokurimit “**Furnizim vendosje pjesë këmbimi dhe mirëmbajtje e automjeteve të Bashkisë Kolonjë viti 2024**”, i cili duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

a.1 Ambienti (servisi/oficina) duhet të jetë brenda territorit të **Bashkisë Kolonjë**. Për këtë, operatori/et ekonomik ofertues, duhet të paraqes/in dokumentacion që vërteton pronësinë / huapërdorjen / qiramarrjen si më poshtë:

a.1.1 Dokumentacion që vërteton pronësinë:

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; **ose**
- kontrata e shitblerjes; **ose**
- kontrata e dhurimit; **ose**
- çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

a.1.2 Dokumentacion që vërteton huapërdorjen:

- Kontratë huapërdorje.

a.1.3 Dokumentacion që vërteton marrjen me qira:

- Kontratë qiraje.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” , i ndryshuar me ligjin nr. **16** datë. **08.02.2024** dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion 1 (një) ambjent/servis brenda territorit të Bashkisë Kolonjë për realizimin/ekzekutimin e shërbimeve objekt prokurimi.

Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve është vlerësuar e domosdoshme/nevojshme që operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, 1 (një) ambient ku ushtrojnë aktivitetin e tyre me qëllim realizimin e shërbimeve objekt prokurimi në kohë dhe cilësi.

Ky kriter është vendosur në mënyrë që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme organizative, për të zbatuar dhe për të përmbushur kontratën në përputhje me specifikimet dhe standardet e kërkuara nga Autoriteti kontraktor dhe nisur nga shumëllojshmëria e mjeteve, specifikat e veçanta të tyre dhe numri i mjeteve për mirëmbajtje.

2.3.4 Operatori/et ekonomik duhet të deklarojë se **Garancia** për pjesët e këmbimit të cilat do u zëvendësohen mjeteve kërkohet të jetë jo më pak se **6 (gjashtë) muaj** për riparimet xhenerike dhe motorrike nga data e daljes së mjetit nga riparimi dhe për gomat/bateritë **garancia** duhet të jetë jo më pak se **1 (një) vit** nga data e daljes së mjetit nga riparimi dhe fituesi i procedurës së prokurimit gjatë kësaj periudhe të garantojë **pa pagesë** riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin që do kryejë .

Argumentimi:Me anë të kësaj deklarate synohet që mallrat që do të dorëzohen të jenë të reja dhe me minimumi një vit garanci dhe që fituesi i procedurës së prokurimit gjatë kësaj periudhe të garantojë për autoritetin kontraktor të përfshirë në këtë procedurë, riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbim pa pagesë konform specifikimeve teknike sa herë të lind nevoja.

2.3.5 Operatori/et ekonomik duhet të deklarojë se ofron shërbimin e kërkuar në këtë procedurë edhe në terren në rast të nevojave të autoritetit kontraktor.

Argumentimi:Me anë të kësaj deklarate synohet që në rast se autoritetit kontraktor do t'i lind nevoja për riparime në terren të hapur, në vende ku makineria që mund të pësojë defekt, është duke kryer funksionet përkatëse, OE do të jetë i gatshëm të kryejë shërbimin në vend, nëse kjo është e mundur pa e transportuar në servis.

2.3.6 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesë deklarate se në ambientet e servisit ku ushtron aktivitetin duhet të ketë pajisjet e nevojshme për realizimin e kontratës, si më poshtë vijon:

- Kompjuter për diagnostikimin e automjeteve,i pajisur me programe për automjetet sipas specifikimeve teknike të dst.
- komperator,set mikrometrash,kalibrash e pajisje të tjera ndihmëse
- pajisje për testimin e injektoreve.
- aparat për kontroll radiator uji.
- ura ngritëse për automjete (veturë/fuoristradë);
- aparat per furnizimin me alkol dhe nxjerrjen e ajrit të sistemit të frenimit;
- pajisje montim-çmontim gomash;
- aparat saldimi me oksigjen
- aparat saldimi me argon

Autoriteti Kontraktor, rezervon të drejtën të inspektojë në vend pajisjet e nevojshme e sipërpërmendura, me qëllim verifikimin e kërkesave të sipërcituara.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimevetë nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, **i ndryshuar** , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik””, i ndryshuar me ligjin nr.16 datë.08.02.2024 dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, dhe është vlerësuar e domosdoshme që operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet dhe pajisjet teknike për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.7 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesë deklaratë nga operatori ekonomik pjesëmarrës që merr përsipër kryerjen e shërbimeve objekt kontrate në vendodhjen e eskavatorit tip Volvo EC 220 D.

Argumentimi: Me anë të kësaj deklarate synohet që ofertuesi të realizojë shërbimin në vendodhjen e eskavatorit pasi ato konsiderohet mjet kantieri dhe është e pamundur nga AK të transportojë ato në pikën e servisit të ofertuesit.

2.3.8 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për makinerite dhe pajisjet teknike, që ka në dispozicion dhe, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës,dhe do të vërë në dispozicion **pa pagesë** automjet të specializuar për transportin e automjeteve të difektuara, si me poshtë:

Nr.	Emri i mjetit	Sasia	Statusi
1	Karrotrec	1 copë	Në pronësi ose me qera

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet:

- a) dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- ç) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;

Kur janë me qera, duhet të paraqitet:

- a) kontrata noteriale e qerasë të vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës;
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- ç) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit .

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimevetë nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me ligjin nr.16 datë.08.02.2024 dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, dhe është vlerësuar e domosdoshme që operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, 1 (një) automjet, konkretisht **pajisjet/karrotrec** për ekzekutimin e objektit të prokurimit.Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtje e automjeteve, mund të ndodh që në raste defekti i cili shkakton teknikisht pamundësinë e lëvizjes vetë të automjeteve OE duhet të transportojë një automjet të difektuar në ambjentet e servisit që disponon **pa pagesë**.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet Teknike dhe termat e referencës për procedurën respektive janë hartuar nga komisioni i Përgatitjes së specifikimeve teknike, termat e referencës dhe përlllogaritjes së fondit limit i ngritur me urdhër nr.392 me nr.4184 prot, datë.11.08.2025, pjesë përbërëse e strukturës së **Bashkisë Kolonjë**, në përputhje me nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar me ligjin nr.16 datë.08.02.2024 si dhe nenit 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet Teknike dhe termat e referencës janë pjesë e setit të dokumentave të ngarkuara në SPE për procedurën respektive.

Argumentimi: Në funksion të realizimit me sukses të detyrave të tij, Autoriteti Kontraktor, Bashkia Kolonjë disponon rreth 24 automjete transporti, tipologjia dhe larmia e të cilave varion që nga veturat, kamionçinat, kamionë me akse të ndryshme, mjete të rënda automjete të transportit të veçantë, të stacionuar për shërbime të ndryshme. Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje të plotë me kërkesat që ka çdo mjet sipas tipologjisë, vitit të prodhimit, kilometrave të përshkuara dhe/ose orëve të punës, me qëllim dhënien e një informacioni sa më të plotë për çdo mjet me qëllim kryerjen dhe sigurimin e një shërbimi cilësor të mjeteve të AK-së.

Fondi Limit i përlllogarit për këtë procedurë është hartuar në përputhje me nenin 34 dhe 35 të ligjit Nr.162/2020 datë.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar me ligjin nr.16 datë.08.02.2024 si dhe neni 76 i Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nga komisioni i Përgatitjes së specifikimeve teknike, termat e referencës dhe përlllogaritjes së fondit limit i ngritur me urdhër nr.392 me nr.4184 prot, datë.11.08.2025, pjesë përbërëse e strukturës së Bashkisë Kolonjë.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt:” : **“Furnizim vendosje pjesë këmbimi dhe mirëmbajtje e automjeteve të Bashkisë Kolonjë viti 2025 – 2026”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

Bashkëlidhur këtij proces-verbali:

- Dokumentat e tenderit
- Preventivi
- Specifikimet teknike dhe termat e referencës.

Njësia e Prokurimit